


Indeksi i Çmimeve të Importit

Tremujori IV, 2024

Tiranë, më 05 Mars: Indeksi i Çmimeve të Importit, në tremujorin e katërt të vitit 2024 arriti 108,0, kundrejt vitit 2021 si periudha bazë. Krahasuar me tremujorin e katërt 2023, indeksi i çmimeve të importit shënoi një ulje me 0,9 %, një vit më parë ky ndryshim ishte me ulje 0,5 %. Ndryshimi tremujor i indeksit të çmimeve të importit në tremujorin e katërt 2024, krahasuar me tremujorin e tretë 2024 ka një rritje te lehtë prej 0,01 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit sipas tremujorëve



Ndryshimi vjetor: Çmimet e importit të produkteve në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avulli dhe ajri i kondicionuar” shënuan ulje me 5,2 %, pasuar nga seksionet “Industria përpunuese”, me peshën më të madhe prej 93,5 %, me 0,7 %, “Industri nxjerrëse” me 0,1 %. Nga ana tjetër, seksioni “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” shënoi një rritje me 0,4 %. Brenda seksionit “Industria përpunuese” ulja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktiviteteve “Konfeksionimi i veshjeve” dhe “Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës” me 2,3 % secili, pasuar nga aktivitetet “Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilieeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi” me 2,1 %, “Metalurgjia” me 1,9 %, “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 1,4 %, “Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t” me 1,2 %, “Prodhimi i pijeve” me 1,1 %, etj. Nga ana tjetër, çmimet në aktivitetin “Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve” shënuan rritje me 1,7 %, pasuar nga aktivitetet “Industri të tjera p.k.t” me 1,4 %, “Prodhimi i pajisjeve elektrike” me 1,0 %, etj.

Ndryshimi Tremujor: Krahasuar me tremujorin e tretë 2024, çmimet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar” shënuan ulje me 1,1 %, pasuar nga seksionet “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,6 %. Nga ana tjetër seksioni “Industria nxjerrëse” shënoi rritje me 0,4 %, pasuar nga seksioni “Industria përpunuese” me 0,1 %. Brenda seksionit “Industria përpunuese”, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Industri të tjera p.k.t” me 1,0 %, pasuar nga aktivitetet “Konfeksionimi i veshjeve” dhe “Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit” përkatësisht me 0,6 % secili, “Përpunimi i tekstileve”, “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” dhe “Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës” me 0,5 % secili. Çmimet e aktiviteteve “Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi”, “Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t” dhe “Prodhimi i mobilie” shënuan një ulje prej 0,3 % secili.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Importit

2021=100

NVE Rev2	Përshkrimi	Peshat	10-24	11-24	12-24	IV-24
	Gjithsej	100	107,9	107,9	108,1	108,0
B	Industria Nxjerrëse	0,2	112,2	112,3	112,3	112,3
08	Nxjerja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	112,2	112,3	112,3	112,3
C	Industria Përpunuese	93,5	106,3	106,4	106,4	106,4
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	11,3	112,6	112,6	112,6	112,6
11	Prodhimi i pijeve	3,1	113,4	113,4	113,4	113,4
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	103,4	103,4	103,4	103,4
13	Përpunimi i tekstileve	4,4	105,9	105,9	105,9	105,9
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,2	103,2	103,3	103,3	103,3
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,8	103,9	103,9	103,9	103,9
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	2,5	101,0	101,3	100,9	101,0
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	2,3	106,1	106,1	106,4	106,2
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	111,3	111,3	111,3	111,3
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	9,8	107,7	107,7	107,7	107,7
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,6	105,4	105,4	105,4	105,4
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	6,3	100,9	100,9	100,9	100,9
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	4,0	99,7	99,7	99,7	99,7
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,6	111,7	111,7	111,6	111,7
24	Metalurgjia	8,6	109,1	109,1	109,1	109,1
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	3,5	108,6	108,6	108,6	108,6
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	3,8	105,7	105,9	106,7	106,1
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	5,6	109,5	109,5	109,1	109,4
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t	5,5	100,7	100,9	101,0	100,9
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,3	111,2	111,2	111,2	111,2
31	Prodhimi i mobiljeve	0,8	101,4	101,4	101,3	101,3
32	Industri të tjera p.k.t	2,0	106,6	106,2	106,9	106,6
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	5,2	140,5	141,2	144,4	142,0
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	5,2	140,5	141,2	144,4	142,0
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,0	107,2	107,2	107,2	107,2
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,0	107,2	107,2	107,2	107,2

Tab. 2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit

		në %		
NVE	Përshkrimi	Peshat	IV- 24 / III- 24	IV- 24 / IV- 23
	Gjithsej	100	0,01	-0,9
B	Industri Nxjerrëse	0,2	0,4	-0,1
08	Nxjerja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	0,4	-0,1
C	Industria Përpunuese	93,5	0,1	-0,7
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	11,3	-0,2	-1,4
11	Prodhimi i pijeve	3,1	-0,1	-1,1
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	0,2	0,4
13	Përpunimi i tekstileve	4,4	0,5	0,1
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,2	0,6	-2,3
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,8	0,2	0,1
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	2,5	-0,3	-2,1
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	2,3	-0,2	-0,2
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	0,5	-0,7
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	9,8	-0,1	-2,3
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,6	0,2	0,7
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	6,3	0,1	0,2
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	4,0	0,5	-0,3
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,6	0,1	-0,4
24	Metalurgjia	8,6	0,1	-1,9
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	3,5	-0,1	1,7
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	3,8	0,1	-0,5
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	5,6	0,2	1,0
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t	5,5	-0,3	-1,2
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,3	0,6	0,8
31	Prodhimi i mobilieve	0,8	-0,3	0,0
32	Industri të tjera p.k.t	2,0	1,0	1,4
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	5,2	-1,1	-5,2
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	5,2	-1,1	-5,2
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,0	-0,6	0,4
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,0	-0,6	0,4

Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Importit mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun vendas,

INSTAT llogarit dhe publikon:

Indeksin e Çmimeve të Importit

Ndryshimet tremujore dhe vjetore të indeksit

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industri Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE rev.2) në nivel 2-shifror.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe tremujorit të mëparshëm.